



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2021:059733

Datë: 21.12.2023

Numri i dokumentit: 05102409

C.nr.172/2021

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË MALISHEVË - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, gjyqtari Besmir Juniku, në çështjen juridike të paditësit A.M. nga fshati G., Komuna e Malishevës, të cilin e përfaqëson Av. Ramadan Paçarizi nga Malisheva, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, kundër të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës – Ministria e Arsimit dhe Shkencës - Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur (AAPARR) me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Ministria e Drejtësisë – Avokatura Shtetërore, sipas bazës juridike - kompensim i shujtave dhe shpenzimeve të udhëtimit, vlera e kontestit 2,281.00 Euro, jashtë seancës gjyqësore, me datën **21.12.2023** merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET** në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit A. M. nga fshati G., Komuna e Malishevës, ashtu që: **OBLIGOHET** Qeveria e Republikës së Kosovës – Ministria e Arsimit dhe Shkencës - Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur (AAPARR) me seli në Prishtinë, që paditësit në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit (shujtave) gjatë punës, për 671 ditë të vajtjes në punë, për periudhën prej datës 01.01.2019 deri më datë 31.10.2022, t’ia paguaj shumën prej 1,342.00 (njëmijë e treqind e katërdhjetë e dy) Euro, duke llogaritur me nga 2.00 (dy) Euro, për çdo ditë të punës dhe në emër të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit për ditët në punë, shumën prej 939.00 (nëntëqind e tridhjetë e nëntë) Euro, në të cilën përfshihet 70% e biletës së udhëtimit prej 2.00 Euro, për relacionin Guriq - Malishevë dhe anasjelltas, përkatësisht shumën e përgjithshme prej **2,281.00** (dymijë e dyqind e tetëdhjetë e një euro) **€uro**.
- II. DETYROHET** e paditura që paditësit t’ia kompensojë shpenzimet e procedurës në shumën prej 229.00 Euro, në afat prej 7 (shtatë) ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësi A. M. nga fshati G., Komuna e Malishevës, të cilin e përfaqëson Av. Ramadan Paçarizi nga Malisheva, në këtë gjykatë ka parashtruar padi ndaj të paditurës Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur (AAPARR) me seli në Prishtinë, sipas bazës juridike kompensim i shpenzimeve të ushqimit (shujtave) dhe shpenzimeve të udhëtimit.

Paditësi përmes të autorizuarit të tij Av. Ramadan Paçarizi, në padi dhe në precizim të kërkesëpadiisë të datës 29.11.2022 ka theksuar se është i punësuar tek e paditura Qendra e Kompetencës “K. K.” në Malishevë, në pozitën profesor dhe ende vazhdon të punoj. Paditësi ka paraqitur kërkesë me shkrim pranë të paditurës për kompensimin shpenzimeve të ushqimit dhe për shpenzimet e udhëtimit gjatë vijueshmërisë në punë, por ende nuk ka pranuar përgjigje formale lidhur me kërkesën, edhe pse ka kaluar afati ligjor prej 30 ditësh. Andaj paditësi përmes kësaj padie i drejtohet gjykatës që të nxjerr vendim me të cilin punëdhënësi Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur, konform Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, obligohet që të punësuarit këtu paditësit për periudhën kohore nga data 01.01.2019 deri me datë 31.10.2022, në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit gjatë punës t’ia paguaj shumën prej 1,342.00 Euro, për 671 ditë pune nga 2.00 Euro dhe në emër të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit t’ia paguaj shumën prej 939.00 Euro në të cilën përfshihet 70% e biletës së udhëtimit prej 2.00 Euro. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar sipas Tarifës së OAK-së.

E paditura Qeveria e Republikës së Kosovës – Ministria e Arsimit dhe Shkencës - Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur (AAPARR) me seli në Prishtinë, përmes Avokaturës Shtetërore ka parashtruar përgjigje në padi me datë 23.12.2022, duke theksuar se e kundërshton padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit në tërësi si të pa bazuar, me arsyetimin se kërkesëpadija e paditësit është mbështetur në Kontratën Kolektive të Arsimit të vitit 2017. E paditura vlerëson se asnjë dispozitë ligjore e kësaj kontrate nuk parasheh veprim retroaktiv për realizimin e kësaj të drejte, gjegjësisht kompensimin e ushqimit. Mbështetur në dispozitën e nenit 1 të Kontratës Kolektive të Arsimit, qëllimi i saj është të përcaktohen të drejtat e posaçme për mësimdhënësit, ndërsa paditësi është shërbyes teknik, e jo arsimtar, andaj edhe padia nuk ka mbështetje ligjore dhe si e tillë duhet refuzuar. Është kontestuese marrëdhënia e punës në mes të paditësit dhe të paditurës sepse nuk është argumentuar me kontratë të punës, nga kjo rrjedh se paditësi nuk është në marrëdhënie pune tek e paditura dhe nuk mund të realizojë një kërkesë të tillë. Mbështetur në dispozitën e nenit 87 të Ligjit të Punës, afati i parashkrimit “*të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para parashkruhen brenda afatit prej 3 vitesh nga dita e paraqitjes së kërkesës*”, Kontrata Kolektive e Arsimit është lidhur për periudhë tre vjeçare, konform nenit 90 të Ligjit të Punës, e që konstatohet se nuk është në fuqi. Po ashtu është fakt notor se gjatë vitit 2020 nuk kanë punuar mësimdhënësit me vijim të rregullt në punë për shkak të pandemisë COVID 19, e që ka kjo rrjedh se e paditura nuk obligohet paditësit t’ia paguaj shpenzimet. Andaj e paditura duke u bazuar në thëniet e lartcekura e posaçërisht faktin se e paditura veç i ka përmbushur detyrimet e saja ndaj paditësit lidhur me shqyrtimin e ankesës, i propozon gjykatës që pas administrimit të provave, të refuzojë në tërësi si të pa bazuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 të LPK-së gjeti se kërkesëpadija e paditësit është e themeltë, andaj pa mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor të çështjes vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga Vërtetimi Nr.704/4/22 i datës 25.11.2022, i lëshuar nga Qendra e Kompetencës “Kujtim Krasniqi” Malishevë, vërtetohet fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura dhe prej datës 01.01.2019 e deri me datë 31.10.2022 ka gjithsej 671 ditë pune.

Me shikimin dhe analizimin e Certifikatës së vendbanimit nr.B10420606 të lëshuar me datë 25.11.2022 nga Zyra e Gjendjes Civile – P.ë - Malishevë dhe vërtetimit të biletave të udhëtimit të lëshuara nga Kombi Taxi “Nebih Kastrati”(të cilave gjykata ua dha besimin e plotë) vërtetohet fakti se paditësi ka vendbanim në G.dhe për të prezentuar në punë, duhet të udhëtoj

në relacionin Guriq – Malishevë dhe anasjelltas dhe të paguaj biletë të udhëtimit në vlerën 2.00 Euro në të dy drejtimet.

Ligji i Punës Nr.03/L-212, neni 90 par.4 dhe 5 e përcakton se *”4. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet” dhe ”5. Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”.*

Sipas nenit 35.7 të Kontratës Kolektive e Arsimit të Kosovës, e datës 18.04.2017 dhe të datës 22.01.2021, është paraparë se: 35.7 *”Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë, vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë për një ditë pune është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënie e punës primare në institucionet arsimore”.*

Sipas nenit 35.5 të Kontratës Kolektive e Arsimit të Kosovës, e datës 18.04.2017 dhe të datës 22.01.2021, është paraparë se: 35.5 *”Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për udhëtim gjatë punës për ditët e pranisë në punë, vlera e kompensimit të shpenzimit të udhëtimit në punë për një ditë pune është 70 % të biletave të trafikut urban për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore”.*

Në pajtueshmëri me dispozitat e lartcekura, gjykata gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, me arsyetimin se nga data 01.01.2019 e deri me datë 31.10.2022, për 671 ditë pune paditësit Afrim Mazreku i takojnë shpenzime të ushqimit për çdo ditë pune nga 2.00 Euro (671 x 2.00 = 1,342.00 Euro) dhe shpenzime të udhëtimit për çdo ditë pune nga 2.00 Euro (671 ditë pune x 2.00 euro biletë x 70% = 939.00 Euro), e që është shuma e përgjithshme prej 2,281.00 Euro. Sipas këtyre dispozitave të Kontratës Kolektive punëdhënësja e fundit është ajo që i paguan shpenzimet e ushqimit dhe shpenzimet e udhëtimit për punëtorët e saj. Në rastin konkret gjykata gjeti se e paditura ka pasur për detyrim që paditësit t’ia paguaj shpenzimet e ushqimit (shujtave) në punë dhe shpenzimet e udhëtimit.

Gjykata me rastin e vendosjes (jashtë seancës gjyqësore) është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë e përcakton se *”Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit merititor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”.*

Bazuar në nenin 398 të LPK-së, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe atë pa caktuar seancë gjyqësore pasi që vlerësoi se në rastin konkret kërkesëpadia e paditësit ishte qartazi e themeltë pasi që ka bazë në dispozitat e ligjore të përmendura më lartë, ndërsa shuma e kompensimit bazohet në provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës në përgjigje në padi, gjykata vlerëson se të njëjtat janë të pabazuara dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike, me të cilën do të duhej të refuzohej kërkesa e paditëses. Pretendimet se pala paditëse nuk ka ofruar prova të mjaftueshme për çmimin e biletës dhe vendbanimin, janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e gjykatës dhe si të tilla janë kundërshtime deklarative. Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë Nr.01B-2056 të datës 18.04.2017 ka qenë në fuqi deri me datë 18.04.2020 dhe kjo pjesë është vazhduar me Kontratën Kolektive të datës 22.01.2021 e cila ka vlefshmëri deri me datë

21.11.2022 (referuar mendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 të datës 05.10.2023), që rezulton brenda periudhës si në kërkesëpadi.

Gjykata analizoi edhe pretendimet tjera të të paditurës, mirëpo vlerësoj se të njëjtat nuk kanë impakt në vendosjen ndryshe nga dispozitivi i këtij aktgjykimi.

Gjykata vendimin mbi shpenzimet e procedurës kontestimore e mbështeti në nenin 452 të LPK-së, e që e paditura është obliguar që paditëit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 125.00 Euro dhe atë në emër të përpilimit të padisë shumë prej 104.00 Euro dhe në emër të taksës gjyqësore për padi shumë prej 21.00 Euro.

Nga sa u tha më lart, e konform dispozitave ligjore të parapara me nenin 398 lidhur me nenin 142 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË MALISHEVË
C.nr.172/2021, datë 21.12.2023

G j y q t a r i
Besmir Juniku

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 (shtatë) ditëve nga dita e pranimit. Ankesa parashtrohet në këtë gjykatë, për Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë.